

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.03.2025*

15.03.2025

Ora 12:04

RENDI I DITËS

“Për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë”, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. L. Veliu, znj. P. Doçaj

Parti Politike: Partia “Lëvizja Bashkë” (znj. Vitori Çipi)

Të tjerë: s’ka prezent

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën publike kemi në rënd dite vetëm një çështje e cila ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Lëvizja Bashkë për miratimin e listave shumemërore për kandidatët për deputetë për zgjedhjet e datës 11 maj 2025. Po, Licela!

Znj. L. Veliu: Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 399, datë 5 dhjetor 2024, ka përcaktuar datën 11 maj 2025, si datë që do të zhvillohen zgjedhjet për Kuvend. Me vendim nr. 146, datë 24 shkurt 2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Partia “Lëvizja Bashkë” me kryetar zotin Arlind Qorri, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Partia “Lëvizja Bashkë”, ka paraqitur pranë KQZ-së dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore për 12 (dymbëdhjetë) qarqe që përbëhen nga: Lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve, lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit


*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.03.2025*

parapëlqyes si dhe nënshkrimet mbështetëse. Në bazë të nenit 68, pika 1 e Kodit Zgjedhor, përcaktohet se lista e kandidatëve për Kuvend të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se pesë mijë zgjedhës në shkallë kombëtare. Administrata e KQZ-së verifikon nënshkrimin e zgjedhësve në listat mbështetëse për të cilat rezultoi se gjithësej janë dorëzuar pesë mijë e pesëqind e njëzet e dy nënshkrime të plotësuara sipas modelit të miratuar nga KQZ. Për çdo zgjedhës në listë, bashkëlidhur është depozituar dhe kopja e letërnjoftimit e nënshkruar prej tyre. Nga administrata e KQZ-së është bërë verifikimi të dokumentacionit të dorëzuar duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i firmave mbështetëse është 280 (dyqind e tetëdhjetë). Në përfundim pas verifikimit rezulton se numri i nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit mbështetës është më i madh se numri minimal i kërkuar në bazë të nenit 68, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata KQZ verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë” për qarqet si vijon: Qarku Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur, nga i cili konstatoi se ishte në përputhje me këkesat e parashikuara në nenin 67 dhe nenin 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët për deputet të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë” kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në KQZ dhe nga verifikimet e tyre rezulton se tek asnjë prej kandidatëve nuk janë deklaruar të dhëna, që lidhen me parashikimet për ndalim në bazë të Ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar. KQZ nëpërmjet komunikimit elektornik ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga numri total prej 186 kandidatëve për deputet të listave shumemërore të subjekti zgjedhor

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.03.2025*

Partia “Lëvizja Bashkë”, rezulton se nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me anë të komunikutit elektronik janë kryer verifikimet e të dhënave për të gjithë kandidatëve për debutet të subjekti zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë”, sipas të cilës 3 (tre) kandidatë për deputet në listës shumemërore të subjektit zgjedhor rezulton të jenë rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal. Kandidatët e tjerë të listës shumemërore të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë” rezulton se nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje për sa i përket verifikimit të të dhënave për kandidatët për deputet të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë”. Referuar Ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Kreut 5, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për kandidatët për deputet të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë”, nuk përbëjnë kusht të mos regjistrimit të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj. Pas verifikimeve përkatëse të kërkeses dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumemërore të subjektit zgjedhor Partia “Lëvizja Bashkë” për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, rezulton se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 68, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Bashkelidhur Projektvendimi për miratimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Përfaqësues e subjektit zgjedhor kanë gjë për të shtuar?

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 15.03.2025*

Znj. V. Çipi: Jo, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Meqenëse dokumentacioni që i është bashkëlidhur kërkesës dhe listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë” është në përpudhje me gjithë parashikimet e Kodit Zgjedhor, miratojmë listat shumemërore për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj të vitit 2025, për të 12 (dymbëdhjetë) qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, të cilat do të bashkëlidhen aktit listat shumemërore për secilin qark. Duke filluar nga dita e hënë do të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit, fushatë të mbarë! Çështje tjetër në rendin e ditës nuk kemi. Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 267

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*

